



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4280 Prot.

Roskovec, më 31.08 2020

V E N D I M

NR 67 , DATË 28.08 .2020

“PËR NJË NDRYSHIM TË BUXHETIT 2020 DHE MIRATIMIN E FONDIT PËR PROJEKTET “TREGJE PUBLIKE TË SIGURTA” DHE FONDIT SHITESË NË KUADËR TË PROJEKTIT ROMACTED

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, neni 9, pika 1.3 dhe neni 54 gërma dh, Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetore në RSH”i ndryshuar neni 44, paragrafi II, gërma a, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore“ neni 45 , të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, VKB nr.116 datë 20.12.2019 “Për miratimin e buxhetit dhe numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarrjet vartëse, si dhe nivelin maksimal të pagave për vitin 2020”, të materialeve të sjella nga sektori i Menaxhimit të Projekteve Sociale, Koordinimit me BE-në dhe Shërbimeve Komunitare, dhe kontratës së lidhur ndërmjet Bashkisë Roskovec dhe UNDP, si dhe të materjaleve të sjella nga Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, Këshilli i Bashkisë,

V E N D O S I :

1. Miratimin e fondit prej **245,000 lekë** për projektin “Tregje Publike të Sigurta- Mekanizmi Lokal COVID-19”, sipas materialit të bashkëlidhur , në kuadër të projektit “Siguria Publike në Nivel Vendor”, zbatuar nga Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG), Akademia e Hagës për Qeverisje Lokale, VNG International, me mbështetjen financiare të Ministrisë së Jashtme të Hollandës, të detajuar si më poshtë vijonë :

Shtohet : Gr.00 Tit.01110 Kap.05 Art.602

245,000 lekë



2. Miratimin e fondit prej **288,000 lekë**, fond shtesë për aktivitete në përgjigje të situatës emergjente COVID-19 për komunitetin Rom, në kuadër të projekti Romacted, financuar nga Këshilli i Evropës, të detajuar si më poshtë vijonë

Shtohet: Gr.00 Tit.01110 Kap.05 Art.602 **288,000 lekë**

3. Miratimin e fondit prej **2,109,365 lekë** për objektin "Sistemi Ngrrohje-ftohje për bashkinë e re", nga i cili **500,000 lekë** financim për vitin 2020 dhe **1,609,365 lekë** financim për vitin 2021. Fondi prej 500,000 lekë të përballohet nga objekti I investimeve "Mbikqyerje dhe kolaudim punimesh -2019" të caktuar në buxhetin e vitit 2020.

Në buxhetin e vitit 2020 bëhet ky ndryshim:

Shtohet: Gr.00 Tit.01110 Kap.05 Art.231 **500,000 lekë**

Pakësohet: Gr.00 Tit.04520 Kap.05 Art.231 **500,000 lekë**

4. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike, sektori i Menaxhimit të Projekteve Sociale, Koordinimit me BE-në dhe Shërbimeve Komunitare dhe sektori i Shërbimeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

